



Republika e Kosovës Ministria e Punëve të Brendshme



**Prezantim për informata
zyrtare:**

**Dokumentet e Udhëtimit të
Republikës së Kosovës**

Njoftim



Republika e Kosovës, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, do të lëshojë për qytetarët e Republikës së Kosovës, katër (4) lloje të pasaportave/dokumenteve të udhëtimit. Këto dokumente janë dokumente zyrtare të udhëtimit, që janë të njohura nga entitetet përkatëse qeveritare brenda Republikës së Kosovës.

Prezantimi në vijim është dizajnuar si informatë për qytetarët e Kosovës dhe qeveritë e huaja, për të siguruar shpërndarje adekuate të informatave, informatat specifike të dokumenteve, elementet e sigurisë së dokumenteve, dhe kriteret përkatëse për të ndihmuar në shpërndarjen transparente të informatave.

Zyra e Ministrit të Punëve të Brendshme, në emër të Republikës së Kosovës, me respekt, ofron vlerësimin e zyrës së tij për bashkëpunim, për të shikuar informatat si në vijim.

Me respekt,



Zenun Pajaziti

Ministër i Punëve të Brendshme

Pasaportat e Udhëtimit, të Republikës së Kosovës




PASAPORTA E UDHËTIMIT



PASAPORTA ZYRTARE



PASAPORTA DIPLOMATIKE




DOKUMENTI I UDHËTIMIT


Pasaporta Diplomatike



- E lëshuar në bazë të ligjit të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-037: Ligji mbi Dokumentet e Udhëtimit.
- Pasaporta diplomatike lëshohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës.
- Pasaporta diplomatike mund t'i lëshohet:
 - Presidentit të Republikës së Kosovës,
 - Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
 - Kryeministrit,
 - Anëtarëve të Qeverisë së Kosovës,
 - Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës,
 - Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës,
 - Ombudspersonit,
 - Zyrtarëve të Shërbimit Diplomatik të Kosovës, përfaqësuesve konzullarë të Republikës së Kosovës, që kanë emërime diplomatike dhe përfaqësojnë detyra zyrtare,
 - Anëtarëve të delegacionit të shtetit të Republikës së Kosovës,
 - Personave që me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, janë dërguar të punojnë në organizata ndërkombëtare, si zyrtarë diplomatik në organizatat e përmendura më lartë,
 - Kurierëve diplomatik të caktuar në interes të Republikës së Kosovës,
 - Personave të caktuar në interes të Republikës së Kosovës.



Pasaporta Diplomatike



- E lëshuar në bazë të ligjit të Republikës së Kosovës nr. 03/L-037: Ligji mbi Dokumentet e Udhëtimit.
- Pasaporta diplomatike lëshohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës.
- Pasaporta diplomatike mund t'i lëshohet:
 - Anëtarëve të familjes së punëtorëve, në misionet diplomatike dhe përfaqësive konzullare jashtë Republikës së Kosovës.
 - Nëse anëtari i familjes, jeton së bashku me familjen jashtë Kosovës.
 - Anëtarët, që janë pjesë e rrethit të ngushtë familjar të personit të përmendur në faqet e mëparshme të këtij informacioni.
 - Dhe atyre që shoqërojnë personin e përmendur në faqet e mëparshme të këtij informacioni.

Pasaporta Zyrtare




- E lëshuar në bazë të ligjit të Republikës së Kosovës nr. 03/L-037: Ligji mbi Dokumentet e Udhëtimit.
- Pasaporta zyrtare lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Kosovës.
- Pasaporta zyrtare mund t'i lëshohet:
 - Stafit politik të Republikës së Kosovës,
 - Punëtorëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme,
 - Personave të punësuar si përfaqësues diplomatik apo konzullar, të cilëve nuk i'u është lëshuar pasaporta diplomatike.
- Gjithashtu, pasaportat zyrtare mund t'ju lëshohen edhe:
 - Anëtarëve të delegacioneve shtetërore të Republikës së Kosovës,
 - Punëtorëve të organeve shtetërore, kur udhëtojnë jashtë vendit zyrtarisht,
 - Personave tjerë të përcaktuar.
 - Nëse është në interes të Republikës së Kosovës.
- Po ashtu, edhe familjarëve të personave me pasaportë zyrtare:
 - Nëse janë anëtarë të rrethit të ngushtë familjar të personit të përmendur në nën-pikën e tretë,
 - Nëse anëtari i familjes jeton së bashku me familjen jashtë Kosovës.



Pasaporta për Udhëtim



- E lëshuar në bazë të ligjit të Republikës së Kosovës nr. 03/L-037: Ligji mbi dokumentet e udhëtimit.
- Pasaporta për udhëtim, lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Kosovës.
- Pasaporta për udhëtim mund t'ju lëshohet:
 - Qytetarëve të Republikës së Kosovës.
 - Për kalim të kufijve shtetëror.
 - Për të dëshmuar identitetin e qytetarit.



Dokumenti i Udhëtimit



- E lëshuar në bazë të ligjit të Republikës së Kosovës nr. 03/L-037: Ligji mbi Dokumentet e Udhëtimit.
- Dokumenti i udhëtimit lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, Republika e Kosovës.
- Dokumenti për udhëtim mund t'i lëshohet:
 - Qytetarëve të Republikës së Kosovës,
 - Personit që mbetet pa pasaportë jashtë vendit,
 - Personit, vlefshmëria e pasaportës, të cilës i ka kaluar afati gjatë udhëtimit jashtë vendit.
- Dokumenti për udhëtim grupor lëshohet nga Ministria e Punëve të Brendshme, e Republikës së Kosovës.
 - I lëshohet jo më pak se pesë (5) dhe jo më shumë se pesëdhjetë (50) qytetarëve, për një udhëtim për në një vend specifik.
 - Udhëheqësi i grupit duhet të ketë pasaportë.
 - Pjesëtarët tjerë të grupit duhet të kenë kartela identifikuese me fotografi, të cilit i dëshmohet identiteti i tij/saj.



Aplikacioni për Pasaportë



Shtojca - 1

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
MINISTRIA E PUNEVE TË BRENDSHME - MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA - MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

P FORMULAR APLIKIMI PËR PASAPORTË
OBRAZAC APLIKACIJE ZA PASOŠ BARKODI

KOMUNA OBSTINA NR. I QKRC-së BH, OCCR-a

NR. PERSONAL LIČNI BR. DATA E APLIKIMIT DATUM APLIKACIJE

I TË DHËNAT E APLIKUESIT - PODACI APLIKANTA

MBIEMRI PREZIME
EMRI IME
DATA E LINDJES DATUM ROĐENJA GJINIA POL
VENDI I LINDJES MESTO ROĐENJA
KOMUNA OBSTINA KODI I KOMUNES OPŠTINSKI KOD
SHTETI I LINDJES DRŽAVA ROĐENJA KODI I SHETIT DRŽAVNI KOD
SHTETESIA DRŽAVLIJANSTVO

A keni qenë i dënuar apo është duke u zhvilluar ndaj jush procedurë penale sipas detyrës zyrtare?
Da li ste bili kažnjeni ili se protiv vas vodi krivični postupak po službenoj dužnosti? PO DA JO NE

A keni poseduar pasaportë më parë? Nëse po, dorëzoni pasaportën!
Da li ste posedovali pasos? Ukoliko jeste, predajte pasos! PO DA JO NE

Arsyet: I dorëzuar I humbur Të tjera:
Razlozi: Predat Izgubljen Ostalo:

Deklaroj, nën përgjegjësi penale dhe materiale se të dhënat e shënuara në këtë formular janë të vërteta dhe të sakta.
Izjavljujem, pod krivičnom i materijalnom odgovornošću, da su podaci navedeni u ovom obrazcu istiniti i tačni.

NËNSHKRIMI I APLIKANTIT / POTPIS APLIKANTA DATE / DATUM

FËLQIMI I PRINDIT / KUJDESTARIK PËR FEMIJËT NËN MOSHËN 18 VJEÇARE
SAGLASNOST RODITELJA / STARATELJA ZA DECU ISPOD 18 GODINA Konfirmoj se aplikuesi është i moshës im dhe e miratohet aplikimin e tij/saj.
Potvrđujem da je aplikator mlađe dobi i saglasan sam sa njegovim zahtevom.

MBIEMRI PREZIME
EMRI IME

NËNSHKRIMET E PRINDIT/VE / PËRFAQËSUESIT LIGJOR
POTPIS RODITELJA / ZAKONNOG ZASTUPNIKA 1. 2.

EMRI I PERSONIT ZYRTAR / IME SLUŽBENOG LICA NËNSHKRIMI I PERSONIT ZYRTAR / POTPIS SLUŽBENOGLICA DATE / DATUM

DËFTESA E FORMULARIT TË APLIKIMIT PËR PASAPORTË / PRIZNANICA OBRASCA APLIKACIJE ZA PASOŠ BARKODI

MBIEMRI PREZIME
EMRI IME
NR. PERSONAL LIČNI BR. DATA E APLIKIMIT DATUM APLIKACIJE

Për të aplikuar për pasaportë të Kosovës, kërkohet që nga qytetari të jepen këto të dhëna personale:

- Emrin personal;
- Numrin personal të qytetarit;
- Datëlindjen;
- Gjininë;
- Vendlindjen;
- Adresën e përhershme;
- Nënshtetësinë;
- Datën dhe vendin e dorëzimit të aplikacionit;
- Emrin, mbiemrin dhe vendndodhjen e përfaqësuesit ligjor nëse është e nevojshme;
- Pyetjen për të kaluarën apo të tashmen kriminale;
- Pyetjen për posedim të pasaportës apo dokumentit të mëparshëm;
- Nënshkrimin e aplikuesit dhe
- ME RËNDËSI:** Aplikuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se falsifikimi i i çfarëdo të dhëna në lidhje me aplikim për pasaportë, mund të çoj në kallëzim penal, dhe pezullim të aplikimit për pasaportë (apo pezullim të pasaportës nëse vetëm është lëshuar). Aplikacioni për pasaportë ka të printuar një deklaratë të tillë në lidhje me këtë çështje të rëndësishme.
- Dëftesa për aplikacion.



Fakte mbi Dokumentet e Udhëtimit

- Pasaportat lëshohen me një afat validiteti prej dhjetë (10) vitesh, nga data e lëshimit.
- Pasaportat diplomatike dhe zyrtare, lëshohen për kohën derisa kryhen detyrat zyrtare, po jo më gjatë se pesë (5) vite.
- Dokumenti i udhëtimit (kartelat për udhëtim), lëshohet për kthim në Republikën e Kosovës, dhe nuk lëshohet për më tepër se tridhjetë (30) ditë.
- Pagesa për aplikim për t'u pajisur me pasaportë për udhëtim apo dokument udhëtimi, momentalisht është përcaktuar në vlerën standarde të 25.00 €. Kërkesa për përsheptim të procedurës për pajisje me pasaportë apo dokument udhëtimi mund të shkaktojë rritje të pagesës.
- Të gjitha dokumentet e udhëtimit-pasaportat do të përmbajnë:
 - Emrin e shtetit të Republikës së Kosovës,
 - Simbolin e Republikës së Kosovës,
 - Emrin e llojit dhe numrin e dokumentit të udhëtimit,
 - Hapësirën për nënshkrim të zyrtarit të autorizuar,
 - Datën e lëshimit të dokumentit të udhëtimit,
 - Datën e përfundimit të vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit,
 - Hapësirën për nënshkrim të mbajtësit të dokumentit të udhëtimit,
 - Të dhënat biometrike personale.

Fakte mbi Dokumentet e Udhëtimit



- Aplikimi për pajisje me pasaportë bëhet me anë të një formulari të veçantë, dhe do të përmbajë të dhënat e aplikuesit në vijim:
 - Emrin personal;
 - Numrin personal të qytetarit;
 - Datëlindjen;
 - Gjininë;
 - Vendlindjen;
 - Adresën e përhershme;
 - Nënshetësinë;
 - Datën dhe vendin e dorëzimit të aplikacionit;
 - Emrin, mbiemrin dhe rezidencën e përfaqësuesit ligjor, dhe
 - Nënshkrimin e aplikuesit.
- Aplikuesi duhet të dorëzojë aplikacionin fizikisht tek autoriteti kompetent .
- Aplikuesi duhet të jetë mbi tetëmbdhjetë (18) apo nëse nën tetëmbdhjetë (18) të cilët kanë të drejtën ligjore të punësohen.
- Aplikuesi nën moshën e tetëmbdhjetë (18), apo nën moshën tetëmbëdhjetë (18), që nuk e ka të drejtën për t'u punësuar duhet të ketë dorëzuar aplikacionin nga ana e përfaqësuesit ligjor.
- Pasaportat, dokumentet e udhëtimit(kartelat) dhe dokumentet grupore të udhëtimit, lëshohen në bazë të kërkesës së qytetarit.
- Pasportat diplomatike dhe pasaportat zyrtare,lëshohen në bazë të kërkesës së organit shtetëror kompetent.

Fakte mbi Dokumentet e Udhëtimit



- Aplikacionet për pasaportë mund të merren në qendrat rajonale të komunave.
- Stafi i Ministrisë, është i aftë për t'ju ndihmuar me procesin për aplikim dhe në pyetjet që mund t'i keni.
- Policët kufitar të Policisë së Kosovës, janë të trajnuar të ndihmojnë qytetarët për të udhëtuar në dhe jashtë Republikës së Kosovës, duke përdorur dokumentet e udhëtimit

Elementet e Sigurisë



Të gjitha pasaportat/dokumentet e udhëtimit të lëshuara nga Republika e Kosovës, do të jenë të prodhuara me elemente specifike të sigurisë.

Elementet e Sigurisë



- Elementet e sigurisë edhe pse konfidenciale, përfshijnë mbrojtje për Republikën e Kosovës, për qytetarët të cilëve ju është lëshuar pasaporta, dhe përmbushin standardet e Evropës dhe SHBA-ve. Elementet e tilla, përfshijnë fletë me ngjyrë speciale, holograme me ngjyra ultraviolete, dhe letër speciale e përdorur për të prodhuar këtë dokument.

- Secili vend përkatës do të këshillohet për llojin e pasaportës së Kosovës, të dhënat biometrike, emblemat dhe elementet tjera, për të siguruar kontinuitet në pikat e hyrjes së vendeve përkatëse.

- Pasaporta e Kosovës ka elemente të shumta të sigurisë.



Pyetje të bëra shumë shpesh



- A duhet të aplikoj për pasaportë në qendrën komunale?
 - Po, ju duhet të aplikoni për pasaportë "tek vendi" në qendrën komunale, afër vendit ku jetoni.
- Si e di, që të dhënat personale dhe dokumentet e dorëzuara do të mbrohen?
 - Ministria e Punëve të Brendshme dhe autoritetet kompetente brenda saj, i bëjnë të gjitha përpjekjet për të mbrojtur dokumentet tuaja dhe identitetin tuaj, nga çfarëdo aktiviteti kriminal. Për më tepër, ligjet/kodet penale të Kosovës në fuqi, lejojnë hetime dhe ndjekje penale për çfarëdo kundërvajtësi që i keqpërdorë ato informata.
- A duhet të marr ndonjë dëftesë për pagesë për aplikim për pasaportë?
 - Po, ju duhet të merrni një dëftesë që është pjesa e poshtme e aplikacionit tuaj për pasaportë. Dëftesa përfshin numrin e aplikacionit tuaj. Dëftesa është e rëndësishme dhe e nevojshme për të marrë pasaportën tuaj.
 - Sa duhet të presë për ta marrë pasaportën ?
 - Ministria e Punëve të Brendshme dhe autoritetet kompetente brenda saj, i bëjnë të gjitha përpjekjet për të lëshuar pasaportën tek ju brenda 14 ditëve, por jo më shumë se 60 ditë.
- A mund të kërkoj përsheptim të procesit të pasaportës për shkak të urgjencës mjekësore jashtë vendit ?
 - Për momentin, nuk ka ndonjë rregullore për përsheptim të pasaportës. Sidoqoftë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe autoritetet kompetente brenda saj, po bëjnë përpjekje për të përpiluar rregullore, sisteme pagesash dhe informata të ngjashme për të krijuar sistemin për aplikim të përsheptuar për pasaportë.



Informata të dobishme për udhëtim

- **Sigurohuni që, i përfillni vizës suaj kur udhëtoni për në një vend të huaj.**
- **Nënshkruani pasaportën dhe plotësoni të gjitha informatat e nevojshme:** Sigurohuni që e keni nënshkruar pasaportën tuaj, dhe vizën, nëse kërkohet, dhe plotësoni të gjitha informatat në faqen e informacionit në pasaportën tuaj.
- **Lëreni kopjen e udhëtimit dhe të dhënat e pasaportës suaj :** Lëreni kopjen e udhëtimit tuaj, të dhënave të pasaportës dhe vizës suaj tek familja apo shokët, që ata t'ju kontaktojnë në rast urgjence.
- **Merrni masa të mos jeni cak i krimit:** Për të shmangur të qenit cak i krimit, mos vishni rroba të pazakonta apo stoli të çmuara dhe mos mbani shuma të mëdha të parave. Gjithashtu, mos lini valixhe të paruajtura në vende publike dhe mos pranoni sende/pako nga të panjohurit.
- **Disa shtete kanë kufizime në atë se çka mund të silltet në vend,** duke përfshirë ushqime të ndryshme dhe barna. Edhe barnat që merren pa recetë janë të ndaluara në disa vende. Bisedoni me ambasadat vendeve që ju shkoni në lidhje me sendet e ndaluara.
- **Të gjithë udhëtarët duhet të mësohen me kushtet që mund të ndikojnë në shëndet tek vendet ku shkojnë.** Për shembull, lartësi e lartë apo ndotje, llojet e spitaleve, imunizimet e nevojshme, mundësitë për barnatore etj.
- **Sugjerohet që udhëtarët që shkojnë jashtë vendit me ndonjë problem shëndetësor paraprak, duhet të mbajnë me vete një letër nga mjeku i tyre,** që shpjegon kushtet mjekësore dhe ndonjë përkrahje të barnave, duke përfshirë emrat e përgjithshëm të barnave të dhëna. Çfarëdo barna, të bartura jashtë vendit duhet lihen në kutitë e tyre origjinale dhe qartë të shënuara. Udhëtarët duhet të shikojnë në ambasadat e vendit që ata shkojnë për t'u siguruar që barnat e nevojshme nuk konsiderohen të jenë narkotik të paligjshëm.



- Për informata të mëtutjeshme dhe për njoftime më të reja vazhdoni të shikoni në vazhdimësi website-in e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Ju faleminderit për vëmendje.



Udhëtoni të sigurt dhe kënaquni!



Zenun Pajaziti
Ministër i Punëve të Brendshme